VENDIM
Nr.730, datë 8.9.2010

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT, TË ZNJ.NAIDA KAPO, NË ITALI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, zëri "Shpenzime operative", t'i shtohet fondi prej 1 100 000 (një milion e njëqind mijë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të znj. Naida Kapo, në Itali.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. Pagesat të bëhen kundrejt paraqitjes së faturave origjinale.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha